



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 571 prot.

Tiranë më, 31.032021

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 02, datë 31.03.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME E SHITESA NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR.03, DATË
21.06.2019 “MBI MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE NË
PROKURORITË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM NË PERIUdhËN PARA
DHE PAS ZGJEDHORE”**

Në mbështetje të neneve 148 e 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, 46 pika 3 shkronja “ç”, 42, 43, 48, 107/1 e vijues të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.148/2020, nenet 24, 25, 74, 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neneve 3, 167/1 e vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligji nr.10019/2008, i ndryshuar, me ligjin nr. 118/2020;

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 5 pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1 Struktura përkatëse dhe/ose prokurori i caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme është pika e kontaktit që i jep KQZ¹-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në

¹ Shih, neni 107/1 “Marrëdhëniet me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve” të ligjit nr.148/2020 që ka ndryshuar ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon:

kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas përcaktimeve në ligj². Informacioni përmban të dhëna/tregues për procedime/çështje penale:

- a) të regjistruara për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
- b) numrin e personave nën hetim dhe/ose të pandehurve;
- c) kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimit të tij;
- ç) numri i kërkesave të prokurorisë për gjykim, sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve;
- d) kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimit të tij;
- dh) të gjykuara dhe disponimi i gjykatës në vendim;
- e) ankimet ndaj vendimeve gjyqësore, shkaku i ankimit dhe çfarë kërkohet;
- ë) të gjykuara në apel dhe disponimi i gjykatës në vendim;
- f) rekursat ndaj vendimeve gjyqësore të apelit, shkaku i rekursit dhe çfarë kërkohet;
- g) të gjykuara në Gjykatën e Lartë dhe disponimi i gjykatës në vendim;
- h) vendime të formës së prerë ndaj të dënuarve të urdhëruara për ekzekutim dhe të ekzekutuara.”

Neni 2

Neni 7, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Me marrjen dijeni për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, prokurori në prokurorinë pranë gjykatës kompetente, pasi vlerëson ekzistencën e kushteve/kritereve ligjorë përkatëse, vendosë regjistrimin e procedimit penal dhe bashkërendon me agjensitë ligjzbatuese të specializuara për kryerjen e hetimeve proaktive, duke përdorur mjetet e posaçme të hetimit.”

Neni 3

Pas nenit 7, shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Mbikëqyrja gjatë ecures së çështjeve

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, numrin e personave nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimin e vendimeve gjyqësore, shkaku i ankimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatit në këtë gjykim. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës.”

¹ Shih, nenet 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 5, 18 e vijues të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

² Shih, nenet 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 5, 18 e vijues të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

Neni 3

Pas nenit 7, shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 7/1

Mbikëqyrja gjatë ecurisë së çështjeve

1. Drejtuesi i prokurorisë përgjigjet për mbarëvajtjen e hetimeve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton³.

2. Drejtuesi i prokurorisë⁴ në momentin e caktimit të procedimit/çështjes për vlerësim/ndjekje prokurorit përkatës, për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, kur e vlerësojnë të nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit/çështjes, nxjerr udhëzim jo të detyrueshme me shkrim⁵ për prokurorin përkatës, për kryerjen e detyrave specifike për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor.

3. Drejtuesi i prokurorisë ndjek në dinamikë veprimtarinë e procedimeve për grupveprat penale në fushën e zgjedhjeve, duke kërkuar informacion nga prokurorët për ecurinë e procedimeve dhe verifikuar përfundimin e secilës çështje, dhe/ose duke nxjerrë udhëzime me shkrim sipas ligjit në rastet kur vlerësohet e nevojshme kryerja e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake nga prokurori⁶. ”

Neni 4

Në nenin 8, në pikat 4 e 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 4 hiqet togfjalëshi “..., veçanërisht për krimet e korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv në zgjedhje...”

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 9, në pikat 2 e 3, bëhen ndryshimet si më poshtë:

³ Shih, nenin 43 të ligjit nr.97/2016, i ndryshuar me nenin 1 të ligjit nr.148/2020, i cili ka shtuar shkronjën “e” me këtë përmbajtje: “e) përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton”

⁴ Shih, shkronja “c”, pika 1 e nenin 48 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete” të ligjit nr.97/2016.

⁵ Shih, shkronjat “b”, “c”, “ç” e vijues nenin 43 në lidhje me nenin 48 të ligjit nr.97/2016.

⁶ Shih, pikat 3, 4 e vijues të nenin 48 të ligjit nr.97/2016.

1. Në pikën 2 togfjalëshi “specialistit për marrëdhëniet me publikun” zëvendësohet me togfjalëshin “...prokurorit ose personelit të caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional...”.

2. Në pikën 3, shkronja “d”, ndryshohen si më poshtë:

“d) Raste e përcaktuara në nenin 5 pika 1 e këtij udhëzimi dhe rastet e tjera që vlerësohen se janë me interes për publikun.”

Neni 6

Neni 10, ndryshohet, si më poshtë:

“Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit⁷ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.”

Neni 7

Neni 11, pika 2, ndryshohet, si më poshtë:


“2. Me mbikëqyrjen e zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm⁸ dhe prokurori e personeli i caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme.”

Neni 8

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



⁷ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c” “ç”, “d” “dh”, “e”, “g”, “i”, “j”, “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “ç”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019.

⁸ Shih po aty, nenin 43 shkronja “dh”.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

I PËRDITËSUAR

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.03/2019¹

**MBI MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURIALE NË PROKURORITË ME
JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM NË PERIUdhËN PARA DHE PAS ZGJEDHJEVE**

(Ndryshime/shtesa me Udhëzimin e Përgjithshëm nr.02/2021²)

Në mbështetje të neneve 148 e 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b”, 46 pika 3 shkronja “ç”, 42, 43, 48, 107/1 e vijues të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.148/2020, nenet 24, 25, 74, 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neneve 3, 167/1 e vijues të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligji nr.10019/2008, i ndryshuar, me ligjin nr. 118/2020;

UDHËZ O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim unifikimin e masat në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si për verifikimin e integritetit të personave/kandidat për tu zgjedhur, ashtu dhe për rritjen e efektivitetit të hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që

¹ Shih, udhëzimi i përgjithshëm i PP nr.3, datë 21.06.2019 me të njëjtin titull;

² Shih, udhëzimi i përgjithshëm i PP nr.37, datë 31.03.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.3, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”.

dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas zgjedhore, si dhe për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

Neni 2 Objekti

Ky udhëzim i përgjithshëm përcakton masa të unifikuara:

a) për organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë së përforcuar në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve;

b) për trajtimin e kërkesave të KQZ-së lidhur me verifikimin e integritetit të personave që janë kandidat për tu zgjedhur;

ç) për mënyrën e sigurimit të informimit në kohë për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe për veprat e tjera të rënda kriminale të lidhura me to;

d) për hetimin dhe ndjekjen penale me përparësi dhe me efikasitet të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, si dhe të çdo veprave penale tjetër që dëmton procesin zgjedhor;

dh) për informimin në prokurori dhe informimin e publikut dhe mediave për veprimtarinë e prokurorisë lidhur me kallëzimet/referimet në prokurori, masat e sigurimit personal, regjistrimet e procedimeve penale në prokurori dhe vendimet ose kërkesat e prokurorëve në gjykatë ndaj autorëve për kryerjen e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat/emërtimet kanë kuptimet, si më poshtë:

1. “Prokurori me juridiksion të përgjithshëm” janë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe Prokuroria e Përgjithshme³.

2. “Periudhë para dhe pas zgjedhjeve” është periudha që fillon me hapjen e fushatës zgjedhore, vijon me ditën e zgjedhjeve dhe përfundon me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

3. “Dita e zgjedhjeve” është data e votimit e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës⁴.

4. “Hapja e fushatës zgjedhore” fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve⁵.

5. “Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor⁶.

6. “Zgjedhje” janë votimet për kuvendin, për njësitë e qeverisjes vendore dhe referendumet⁷.

7. “Zgjedhje të pjesëshme” janë votimet për të plotësuar vendin e kryetarit të bashkisë, si dhe për zgjedhjen e një këshilli të ri vendor në rast shpërbërje.

³ Shih, nenin 2 shkronja “d” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

⁴ Shih, nenin 92 shkronja “gj” e Kushtetutës dhe pikën 1 të nenin 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

⁵ Shih, nenin 77 të Kodit Zgjedhor, që në pikën 1 parashikon: “1. Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve...”

⁶ Shih, po aty pikën 18 të nenin 2.

⁷ Shih, po aty pikën 23 të nenin 2.

8. "KQZ" është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor⁸.

9. "KZAZ" është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor, për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore⁹.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GATISHMËRISË DHE SIGURIMI I INFORMACIONIT NË PROKURORI

Neni 4

Masat për organizimi dhe funksionimin e gatishmërisë

1. Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm drejtuesit e prokurorive marrin masat e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gadishmërisë në periudhën para dhe pas zgjedhore, duke dyfishuar numrin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të gatshëm.

2. Shërbimi i gadishmërisë kryhet në ambjentet e prokurorisë nga ora 7.00 deri në orën 22.00. Pas orës 22.00 personeli i gatishmërisë komunikon me sallën operative të policisë ose me shërbimin e informacionit në Drejtorinë dhe/ose Komisaratin e Policisë vendore përkatëse.

3. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të caktuar në gadishmëri, duhet të garantojnë disponueshmërinë e tyre në çdo kohë për zgjidhjen e çështjeve të ngutshme dhe të jenë të arritshëm në çdo moment nga strukturat e seksioneve dhe/ose shërbimeve të policisë gjyqësore.

4. Drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, informojnë Prokurorinë e Përgjithshme pa vonesë, për grafikun e shërbimit të gadishmërisë sipas pikës 1 të këtij neni dhe numrat e telefonit fiks dhe/ose celular të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të caktuar në shërbimin e gadishmërisë.

5. Numrat e telefonave i njoftohen dhe strukturave të shërbimeve të policisë gjyqësore përkatëse.

6. Drejtuesit dhe/ose prokurorët e caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme, informohen nga drejtuesit e prokurorive për treguesit kryesorë të veprimtarisë dhe problematikën lidhur me veprat penale në këtë fushë, në kuadrin e përkujdesjes për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 5

Bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me publikun

(Ndryshuar pikat 1 e 4 të këtij neni me nenin 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

1 Struktura përkatëse dhe/ose prokurori i caktuar në Prokurorinë e Përgjithshme është pika e kontaktit që i jep KQZ¹⁰-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në

⁸ Shih, po aty pikën 7 të nenin 2.

⁹ Shih, po aty pikën 8 të nenin 2.

¹⁰ Shih, neni 107/1 "Marrëdhëniet me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve" të ligjit nr.148/2020, hyrë në fuqi me date 28.01.2021 (FZ-Nr.5/2020), që ka ndryshuar ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i cili parashikon:

kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor, ndalimin e publikimit të akteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas përcaktimeve në ligj¹¹. Informacioni përmban të dhëna/tregues për procedime/çështje penale:

a) të regjistruara për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

b) numrin e personave nën hetim dhe/ose të pandehurve;

c) kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimit të tij;

ç) numri i kërkesave të prokurorisë për gjykim, sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve;

d) kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimit të tij;

dh) të gjykuara dhe disponimi i gjykatës në vendim;

e) ankimet ndaj vendimeve gjyqësore, shkaku i ankimit dhe çfarë kërkohet;

ë) të gjykuara në apel dhe disponimi i gjykatës në vendim;

f) rekursat ndaj vendimeve gjyqësore të apelit, shkaku i rekursi dhe çfarë kërkohet;

g) të gjykuara në Gjykatën e Lartë dhe disponimi i gjykatës në vendim;

h) vendime të formës së prerë ndaj të dënuarve të urdhëruara për ekzekutim dhe të ekzekutuara.

2. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm shkëmbejnë informacione, si me shërbimet e policisë gjyqësore në Drejtorinë dhe/ose Komisariatin vendore përkatës, ashtu dhe me agjensitë e zbatimit të ligjit dhe shërbimet inteligjente, për të marrë dijeni menjëherë për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve apo për veprat penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimorë dhe ndalimin e publikimit të akteve sipas ligjit¹².

3. Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve zhvillojnë aplikacione kompjuterike të përbashkëta për të ftuar qytetarët për të denoncuar shkeljet e ligjit ditën e zgjedhjeve.

4. Në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme krijohet rubrika për të ftuar qytetarët të kallëzojnë shkeljet e ligjit që kanë cënuar interesat e tyre si zgjedhës ose të konstatuara prej tyre¹³, në periudhën para zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

Neni 6

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, numrin e personave nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimitimin e vendimeve gjyqësore, shkaku i ankimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë edhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas pikës 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës."

¹⁰ Shih, nenet 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 5, 18 e vijues të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";

¹¹ Shih, nenet 103, 279 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 5, 18 e vijues të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";

¹² Shih, nenet 103, 104 e 279 të K.Pr.Penale.

¹³ Koment: Hequr togfjalëshi "...veçanërisht lidhur me veprat penale të korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv në zgjedhje..." për arsyet se, referuar nenit 75/a të K.Pr.Penale, i ndryshuar me ligjin nr.147/2020 datë 17.12.2020, hyrë në fuqi me date 28.01.2021 (FZ-Nr.5/2020), nenet 328 e 328/b të Kodit Penal, i kanë kaluar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme.

Verifikimi i integritetit të personave që zgjidhen

Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë Prokurorisë së Përgjithshme trajton me prioritet kërkesat e KQZ-së për verifikimin e integritetit të personave kandidatë për tu zgjedhur, kërkesa të shoqëruara me formularët e vetëdeklarimit dhe relacionin/dokumentacionin përkatës, për verifikimin e thelluar në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në bashkërendim me prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe me agjensitë e zbatimit të ligjit, si brenda vendit, ashtu dhe ato ndërkombëtare, për të evituar zgjedhjen e atyre kandidatëve që i ndalohej të ushtrojnë funksione publike.

KREU III

KRYERJA E HETIMEVE DHE USHTRIMI I NDJEKJES PENALE

Neni 7

Kryerja e hetimet proaktive

(Ndryshuar pika 1 me nenin 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

1. Me marrjen dijeni për vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, prokurori në prokurorinë pranë gjykatës kompetente, pasi vlerëson ekzistencën e kushteve/kritereve ligjorë përkatëse, vendosë regjistrimin e procedimit penal dhe bashkërendon me agjensitë ligjzbatuese të specializuara për kryerjen e hetimeve proaktive, duke përdorur mjetet e posaçme të hetimit.

2. Prokurori në respektim të procedurës ligjore autorizon ose mbi kërkesën e tij me vendim gjyqësor autorizohet përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes të zbatimit të tyre, mundëson, si parandalimin dhe/ose ndërprerjen e mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjen/finalizimin me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e personave të përfshirë në kryerjen e veprave penale në këtë fushë.

Neni 7/1

Mbikëqyrja gjatë ecures së çështjeve

(Shtuar me nenin 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

1. Drejtuesi i prokurorisë përgjigjet për mbarëvajtjen e hetimeve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton¹⁴.

2. Drejtuesi i prokurorisë¹⁵ në momentin e caktimit të procedimit/çështjes për vlerësim/ndjekje prokurorit përkatës, për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, kur e vlerësojnë të nevojshme për mbarëvajtjen e ecures së procedimit/çështjes, nxjerr udhëzim jo të detyrueshme me shkrim¹⁶ për prokurorin përkatës, për

¹⁴ Shih, nenin 43 të ligjit nr.97/2016, i ndryshuar me nenin 1 të ligjit nr.148/2020, hyrë në fuqi me date 28.01.2021 (FZ-Nr.5/2020), i cili ka shtuar shkronjën “e” me këtë përmbajtje: “e) përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton”

¹⁵ Shih, shkronja “c”, pika 1 e nenin 48 “Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete” të ligjit nr.97/2016.

¹⁶ Shih, shkronjat “b”, “c”, “ç” e vijues nenin 43 në lidhje me nenin 48 të ligjit nr.97/2016.

kryerjen e detyrave specifike për të garantuar një hetim të plotë e të gjithanshëm në kuadrin e një procedimi të drejtë dhe të rregullt ligjor.

3. Drejtuesi i prokurorisë ndjek në dinamikë veprimtarinë e procedimeve për grupveprat penale në fushën e zgjedhjeve, duke kërkuar informacion nga prokurorët për ecurinë e procedimeve dhe verifikuar përfundimin e secilës çështje, dhe/ose duke nxjerrë udhëzime me shkrim sipas ligjit në rastet kur vlerësohet e nevojshme kryerja e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake nga prokurori¹⁷.

Neni 8

Hetimi, ushtrimi i ndjekjes penale, ngritja dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq

(Ndryshuar pika 4 dhe shfuqizuar pika 5 me nenin 4 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

1. Prokurorët vlerësojnë dhe trajtojnë me prioritet çdo referim apo kallëzim për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të çdo vepre tjetër penale që dëmton procesin zgjedhor.

2. Me urdhërimin e regjistrimit të proçedimit penal për veprat penale në fushën e zgjedhjeve, prokurorët t'i delegojnë veprimet hetimore oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit, duke urdhëruar, si kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, ashtu dhe përcaktojnë afate kohore të përshpejtuara për kryerjen e tyre, si dhe të mbikëqyrin periodikisht zbatimin e urdherimeve të tyre, deri në përfundim të hetimeve paraprake për secilin procedim.

3. Prokurorët të kryejnë me përparësi veprimet procedurale, për të siguruar: -hetime të plota dhe gjithëpërfshirës të çështjeve; -ngritjen e akuzës në gjykatë bazuar në rrethanat e faktit të provuara dhe në ligjin material penal e procedural penal të zbatueshëm; -përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykatë me pavarësi, profesionalizëm dhe integritet, duke garantuar mbrojtjen e zgjedhjeve të lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, ashtu dhe liritë personale dhe interesat e ligjshme të shtetasve.

4. Prokurorët në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e masave të dënimit për këto grupvepra penale, të ashpërsojnë kërkimet, si për llojin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe për llojin dhe masat e dënimit për veprat penale më të përhapura dhe me tendencë në rritje në shkallë vendi apo në njësitë administrative në kompetencë tokësore të gjykatës pranë të cilës ushtron funksionet prokuroria¹⁸.

Neni 9

Raportimi periodik në prokurori dhe informimi i publikut dhe medias

(Ndryshuar pikat 2 dhe shkronja "d" e pikës 3 me nenin 5 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

¹⁷ Shih, pikat 3, 4 e vijues të nenin 48 të ligjit nr.97/2016.

¹⁸ Koment: Në pikën 4 të nenit 8 hequr togfjalëshi "... veçanërisht për krimet e korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv në zgjedhje.", për arsyet se, referuar nenit 75/a të K.Pr.Penale, i ndryshuar me ligjin nr.147/2020 datë 17.12.2020, hyrë në fuqi me date 28.01.2021 (FZ-Nr.5/2020), nenet 328 e 328/b të Kodit Penal, i kanë kaluar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Posaçme.

1. Prokurorët në prokuroritë e të gjitha niveleve me juridiksion të përgjithshëm që sigurojnë të dhëna të përcaktuara në këtë nen i dërgojnë tek prokurori për marrëdhëniet me publikun për përpilimin e raportit njëzet e katër (24-tër) orësh për veprimtarinë e të gjithë prokurorëve për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe për çdo veprë penale tjetër që dëmton procesin zgjedhor.

2. Prokurori për marrëdhëniet me publikun të gjitha informacionet e nevojshme, që nuk çënojnë ruajtjen e sekretit hetimorë dhe ndalimin e publikimi tyre, duhet t'ia dërgoj prokurorit ose personelit të caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili i përditëson dhe i publikon në faqen zyrtare të sistemit të prokurorisë (ëëë.pp.gov.al).

3. Raporti periodik njëzetekatër orësh duhet të përmbajë të dhëna për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve lidhur me:

- a) Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit;
- b) Kërkesat për caktimin e masave të sigurimit “arrest në burg”;
- c) Numrin e akuzave të ngritura dhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjyq;
- ç) Njoftime për kërkesat e prokurorëve në gjykatë dhe vendimet përkatëse gjyqësore që evidentojnë arritjet/rezultatet e prokurorisë;
- d) Raste të përcaktuara në nenin 5 pika 1 e këtij udhëzimi dhe rastet e tjera që vlerësohen se janë me interes për publikun.

4. Prokurori për marrëdhëniet me publikun harton raportin mujor bazuar në raportet periodike njëzetekatër orësh për treguesit mesiper për këto grupvepra penale.

5. Me referimin nga policia gjyqësore në prokurori të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, në momentin që prokurori urdhëron regjistrimin e procedimit penal, policia gjyqësore ndërpret çdo komunikim me publikun dhe mediat për të dhënat në atë referim, pa pëlqimin e prokurorit të çështjes dhe/ose prokurorit për marrëdhëniet me publikun.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 10

Përgjegjësia disiplinore

(Ndryshuar me nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit¹⁹ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.

Neni 11

Zbatimi dhe mbikëqyrja

(Ndryshuar pika 2 me nenin 7 të udhëzimit të përgjithshëm nr.02/2021)

¹⁹ Shih, nenin 148/d paragrafi 1 i Kushtetutës dhe nenet 101 pika 1 shkronja “a” “b” dhe 102 pika 1 shkronjat “c” “ç”, “d” “dh”, “e”, “g”, “i”, “j”, “nj”; pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar me ligjin nr.48/2019.

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të të gjithë llojeve dhe niveleve, prokurorët, drejtuesit e prokurorive dhe nëpunësit civil e punonjësit e administratës të gjithë niveleve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm²⁰.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm²¹ dhe prokurori e personeli i caktuar pranë Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm²².

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

²⁰ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016.

²¹ Shih po aty, nenin 43 shkronja “dh”.

²² Shih po aty nenin 46 pika 4.